



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi

Mbledhja nr. 40
Prishtinë, më 17.10.2018, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 225

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Valentina Bunjaku-Rexhepi, Driton Çausi, Arbërie Nagavci, Mufera Shinik, Fidan Rekaliu dhe Albulena Balaj-Halimaj.

Munguan: Nezir Çoçaj, Abdyl Salihu dhe Verica Çeraniq.

Përfaqësues të tjerë: Besim Beqaj, ministër i MIN; Mevlide Shamolli, Ministria e Financave; Rrahman Jashari e Ymer Ymeri, SBASHK; KDI dhe përfaqësues të mediave.

Stafi mbështetës i komisionit: Lule Ymeri, Shaip Goxhuli dhe Rudinë Fetahaj.

Mbledhjen e kryesoi, Ismajl Kurteshi, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-073 për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99;**
- 3. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari i komisionit propozoi që rendi i ditës të plotësohet edhe me një pikë të re të rendit të ditës: **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-129 për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës/Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë dhe GIZ (Giz Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit- Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar) për bashkëfinancimin e projektit CETEP.**

Anëtarët e komisionit, unanimisht, u pajtuan që të plotësohet rendi i ditës me pikën e propozuar dhe të radhitet si pikë e dytë e rendit të ditës.

2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-129 për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës/Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë dhe GIZ (Giz Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit/Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar) për bashkëfinancimin e projektit CETEP

Besim Beqaj, ministër i Inovacionit, tha se marrëveshja e nënshkruar në mes Qeverisë së Republikës së Kosovës/Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë dhe GIZ, ka vlerën e 2.4 milionë euro dhe është në kuadër të programit CETEP, dhe për këtë marrëveshje, ai tha se ministria ka ndarë buxhetin prej 1.2 milion euro dhe 1.2 milion euro do t'i ndajë GIZ-i. Ai sqaroi që projekti është 3 vjeçar dhe parashihet që për inovacion në ndërmarrje të vogla dhe të mesme 800.000 euro në tre vite, për biznese të reja në 3 sektorë në teknologji informative prodhim dhe bujqësi 420.000 euro, për promovim të sektorëve që kanë potencial për eksporte 600.000 euro dhe asociacionet e biznesit të udhëhequra nga gratë 300.000 euro. Ministri tha se ky projekt do të ndikojë në transferimin e kampit ushtarak në Prizren në park gjermano-kosovar për trajnim dhe që e gjithë infrastruktura do t'i transferohet Qeverisë. Ai tha se sipas marrëveshjes mes dy qeverive, parku do të udhëhiqet 3-5 vite nga Qeveria e Gjermanisë. Ai tha se ajo që po tentohet aktualisht nga ministria, është riorientimi i mendimit ekonomik dhe përmendi konferencën ndërkombëtare të organizuar nga ministria, në bashkëpunim me komisioneren e BE-së për Ekonomi Digjitale.

Teuta Haxhiu, tha se edhe pse kjo ministri është e re dhe me një numër simbolik të stafit, po tregon që po ec tutje, drejt fuqizimit të projekteve dhe hapjeve të mundësive për biznese të reja për rininë dhe gratë. Ajo tha se fakti që buxheti është i planifikuar, tregon për një projekt serioz ndërmjet dy qeverive, sepse planifikimi i duhur dhe i drejtë sjell diçka të re dhe inovative.

Komisioni, unanimisht, u deklarua për procedimin e këtij projektligji dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohet Projektligji nr. 06/L-129 për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës/Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë dhe GIZ-it (Giz Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit/Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar) për bashkëfinancimin e projektit CETEP.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-073 për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99

Ismajl Kurteshi, tha se komisioni ka pranuar disa rekomandime nga SBASHK-u. Po ashtu, në takimin e fundit është kërkuar nga anëtarët e komisionit, të cilët nuk janë pajtuar me amendamentet e propozuara, që të bëjnë propozime konkrete në nene të caktuara. Ai propozoi që të shqyrtohet projektligji nen për nen dhe pastaj komisioni do të votojë.

Ymer Ymeri, tha se propozimi i SBASHK-ut , te neni 1 është menduar që qëllimi i ligjit është të krijohet një ligj për pensione dhe propozoi të shtohet fjala "... përvojës së punës së beneficuar për persona të merituar". Ata, gjithashtu, propozuan që 1 vit i punës të jetë i barabartë me 20 muaj, duke synuar që pensioni të mos jetë 75 euro, por i barabartë me skemat pensionale.

Ismajl Kurteshi, tha se për këto çështje nevojitet edhe një konsultim me juristë, sepse sipas ligjit është e përcaktuar e drejta e stazhit të beneficuar në kategori.

Arbërie Nagavci, tha se duke marrë parasysh faktin që dje kemi pranuar disa propozime të reja nga SBASHK-u, komisioni nuk i ka shqyrtuar. Ajo tha se në këtë mbledhje të hedhen të gjitha propozimet e ndryshme dhe pastaj të mbahet edhe një mbledhje, ku do të arrihet një konsensus, si komision, para hedhjes në votim.

Valentina Bunjaku – Rexhepi, tha se në takimin e kaluar është ndryshuar neni 7 dhe për këtë arsye SBASHK-u ka dalë me një propozim konkret, mirëpo që ligjërisht llogaritja e 20 muajve, si 1 vit, nuk do të ishte e mundur. Ajo propozoi që të ketë ndryshime, përsëri te neni 7 dhe të propozohet konkretisht pensioni bazë i mësimdhënësve të viteve të 90-ta. Gjithashtu, ajo tha se komisioni duhet të organizojë edhe një grup punues dhe të dalë me propozime konkrete, sepse këta mësimdhënës nuk kanë nevojë për lëmoshë.

Teuta Haxhiu, tha se komisioni është mbledhur, me qëllim që secili propozim të diskutohet dhe të votohet. Ajo tha se nuk duhet bërë politikë për këtë projektligj dhe që përvoja e mësimdhënësve të viteve të 90-ta ka qenë e njohur edhe më herët, para dy vitesh. Ajo tha se çështja e pensioneve prej 75 euro nuk vlen vetëm për punëtorët e arsimit, por për shumë punëtorë në sektorët e tjerë dhe kjo është më shumë se shkelje e të drejtave të njeriut, mirëpo kjo çështje do të rregullohet.

Rrahman Jashari, tha se ky ligj ka historik 5 vjeçar dhe është turp të zgjatet më shumë. Ai tha se qëllimi i këtij është që mësimdhënësit e atyre viteve të dallohen pak nga kategoritë e tjera që nuk kanë kontribuar. Ai shtoi se Ministria e Punës ka paraparë buxhetin dhe nuk do të ketë mundësi që shteti të kolapsojë. Gjithashtu, ai tha se shteti duhet të kontribuojë për mësimdhënësit që kanë vu gurëthemet e para të arsimit.

Ismajl Kurteshi, tha se përfaqësuesja e Ministrisë së Financave është dakorduar me projektligjin e shqyrtuar nga anëtarët e komisionit. Gjithashtu, theksoi se asnjëri nga deputetët nuk synon dëmtimin e këtyre mësimdhënësve.

Valentina Bunjaku-Rexhepi, tha se nëse mësimdhënësit marrin këtë që po parashihet me këtë projektligj, është nënçmuese. Ajo tha se ky projektligj, me këtë buxhet do të hartohet edhe më herët dhe nëse edhe këtë herë nuk ka buxhet, atëherë mos të kalojë as këtë herë, mirëpo jo t'i fyejmë ata. Gjithashtu, ajo tha se duhet të jemi shumë korrekt, syhapur, në mënyrë që të mos ndodhë ajo që ka ndodhur me veteranët. Ajo tha se komisioni duhet të japë kontributin e vet, me propozime e pastaj Kuvendit të vendosë. Më tej, tha se nëse nuk përmbushën kërkesat e Qeverisë, ajo do të votojë kundër.

Mevlide Shamolli, tha se Ministria e Financave është e interesuar të ndihmojë në aspektin teknik dhe profesional dhe që buxheti i përgjithshëm votohet nga deputetët. Ajo tha se % janë llogaritur dhe me këtë kalkulim do të mund të tejkalohet një rrezik financiar. Është obligim i Ministrisë së Financave të tregojë transparencë, shtoi ajo.

Arbërie Nagavci, tha se faji pse ka kualitet të dobët në shkolla nuk është tek mësimdhënësit mirëpo te politikat që hartohen, përkatësisht të MASHT-it, ministri me të cilën ka qeverisur PDK tash e sa vite. Ajo tha se nëse diçka është bërë siç duhet në arsim, ka qenë falë kontributit të mësimdhënësve të ndërgjegjshëm. Më tej, theksoi se është përgjegjësi e deputetëve ta ruajnë buxhetin, mirëpo nuk duhet mbyllur sytë edhe para shpenzimeve të tjera që kryhen. Te neni 7, ajo propozoi që vlera e përfitimit të jetë fikse, nga 75 euro për mësimdhënësin, që është mbi vlerën mesatare për aq muaj sa kanë kontribuar dhe që totali i bie të jetë më pak se shuma që është përcaktuar. Ajo, gjithashtu, tha se që kjo të mos jetë ngarkesë për buxhetin, të zbatohet për 5 vite të caktuara.

Teuta Haxhiu, tha se nuk gjasa që një person që nuk ka punuar si mësimdhënësin të deklarohet që ka punuar si një i tillë, sepse komisioni i caktuar do të vlerësojë këta persona dhe do të ketë dëshmitarë. Ajo tha se ka të tillë që kanë ndërruar jetë dhe duke llogaritur edhe ata të cilët përfshihen në skema tjera, i bie që është një numër shumë i ulët i përfituesve.

Valentina Bunjaku – Rexhepi, tha se Qeveria e ka sjellë këtë projektligj dhe i ka menduar edhe mjetet për ta zbatuar. Ajo tha se problematika qëndron te neni 7 dhe do të duhet që të diskutohet rreth këtij neni dhe të votohet, në mënyrë që mësimdhënësit ta kenë një pension të merituar.

Albulena Balaj–Halimaj, tha se edhe pse ministria e ka sjellë këtë projektligj, janë deputetët ata që votojnë dhe vendosin, se a ka apo jo buxhet për ta miratuar. Ajo pyeti përfaqësuesit e SBASHK-ut, se a janë të përfshira trustet pensionale në propozimet e tyre. Më tutje, tha se nëse nuk është i përfshirë trusti pensional, atëherë kjo shifër është shumë e madhe, mirëpo nëse janë të llogaritura edhe trustet, atëherë pajtohet me propozimin e tyre. Gjithashtu, ajo tha se edhe nëse te propozimet e komisionit janë të përfshira edhe pensionet, atëherë pajtohet me propozimin e komisionit.

Ymer Ymeri, tha se Ministria e Financave nuk i ka bërë listat, sepse nuk e di se kush ka punuar në arsim e kush jo, mirëpo i ka marrë nga MASHT-i, të gatshme. Ai, gjithashtu, tha se përfaqësuesja e ministrisë ka nënshkruar deklaratë në projektligjin që ka ardhur nga Qeveria.

Mevlide Shamolli, tha se në shkresë janë të paraqitura edhe rreziqet financiare, nëse lexohet me kujdes. Ajo tha se është e vërtetë që listat janë marrë nga MASHT-i, mirëpo që puna profesionale është kryer nga Ministria e Financave.

Ismajl Kurteshi, tha se 6 milionë euro do të jetë shifra, nëse të gjithë ata që pensionohen e kanë pensionin 240 euro. Mirëpo, nëse e kanë pensionin 75 euro, 150 euro ose 170 euro, e kështu me radhë, shuma e cila do të shtohet për t'u arritur vlera 300 euro, e bën koston 30 milionë. Andaj, ai tha se komisioni ka propozuar që shtesa të jetë mbi pensionin që e merr. Tutje, ai tha se për secilin vit duhet të ketë kategori të veçantë, sepse është e padrejtë të vlerësohet njësoj ai që ka punuar 1 vit me ata që kanë punuar 10 vjet. Gjithashtu, duhet bazuar edhe në kualifikimet dhe kapacitetet e mësimdhënësve, që të mos bëhet padrejtësi. Po ashtu, tha se SBASHK-u është pajtuar që të kategorizohen pensionet dhe që shtesat që dalin nga ato vite të punës, të vendosen mbi pensionin bazë të individit, komisioni do t'i harmonizojë propozimet dhe pastaj të hidhet në votim.

4. Të ndryshme

Në këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 14:25.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,
Ismajl Kurteshi